



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Ae.nr.387/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtarë në çështjen juridike të paditësit N.N.T [“A...”], me seli në Podujevë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [F.M], kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [V.J] nga Prishtina, me objekt kontesti shpërblimi i dëmit, në shumën e përgjithshme prej 45,162.00€, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.109/18 i datës 23.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.109/18 i datës 23.09.2019, në pjesën aprovuese vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 45,162.00€, detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj kamatën sipas normës vjetore prej 12 %, duke filluar nga data 12.03.2019 e deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, ndërsa sa i përket pjesës tjetër refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të paditurës dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.109/18 i datës 23.09.2019.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses N.N.T [“A...”], me seli në Podujevë e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë, ashtu që në pikën I të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër të shpërblimit të dëmit t’ia paguaj paditëses shumën e mjeteve në lartësi prej 45,162.00€ me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, duke filluar nga data 12.03.2019 deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit ligjor. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në lartësi prej 5,018.00€ si e pabazuar. Në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,368.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën aktgjykimin e atakuar ta anulojë dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në shqyrtim dhe vendosje.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka paraqitur edhe pala paditëse N.N.T [“A...”], me seli në Podujevë, për shkak të konstatimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Apelit

ankesën ta aprovoje, aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë në drejtim të rritjes së shumës së kompensimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.
ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi N.N.T ["A..."], me seli në Podujevë, me datën 28.02.2018 kanë paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke kërkuar nga gjykata që të miratohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për veturën e siguruar t'ia kompensojë dëmin material në vlerën prej 80,000.00€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 15 ditësh dhe me kamatë ligjore prej 12% nga data e shkaktimit të rastit të siguruar vjedhjes e deri në ditën e pagesës përfundimtarë.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nga raporti policor të datës 26.01.2017, nr. Ref. ..., është vërtetuar fakti se personi [A.J] që është personi i autorizuar i paditëses ka paraqitur rastin në polici se me datën 26.01.2017 është raportuar rasti i vjedhjes së veturës së tipit "Range Rover" me targa të regjistrimit Nga polica e sigurimi kasko me numër ... të lëshuar nga e paditura dhe kushteve të përgjithshme është vërtetuar se paditësi dhe e paditura me datën 11.01.2017 kanë lidhur policën e sigurimit të automjetit kasko për mjetin motorik Land Rover të tipit Range Rover Sport me targa të regjistrimit ..., ku kohëzgjatja e e policës ka qenë deri me datën 11.01.2018. Me aktgjykimin penal P.nr.2729/17 të datës 18.10.2017 është vërtetuar se i padituri [I.B] është liruar nga aktakuza kinse me datën 25.02.2017 rreth orës 21:30 minuta në Prishtinë rruga "..." në lagjen ... në bashkëveprim me personat NN me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme e ka thyer xhamin e djathtë të pasagjerit të veturës të tipit Land Rover model sport pronë e [A.J]. Nga emailit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë të cilët janë përgjigjur me kërkesën e gjykatës, të datës 29.05.2019, është konstatuar se e njëjta prokurori ka njoftuar se pas verifikimit të data bazën e të dhënave rezulton se lidhur me këtë çështje është ngritur aktakuze ndaj personit [I.B] dhe se asnjë person tjetër nuk është i përfshirë në këtë çështje penale. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të makinerisë z.[N.SH] të dhënë në ekspertizën e datës 12.03.2019, ka vërtetuar se vlera e automjetit të markës Land Rover, tipit Range Rover Sport me tabela të regjistrimit ... në ditën e vjedhjes ka qenë në shumën prej 50,180.00€. Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se sa i përket lartësisë besimin ia fali ekspertizës teknike e cila ekspertize përcakton se vlera e veturës në shumën prej 50,000.00€, duke ia zbritur shumën prej 5,018.00€ e cila shumë përputhet me pjesën e zbritshëm në rast të vjedhjes prej 10.00%.

Prandaj, mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 130 par.1, 946 par.3, si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ku është përcaktuar se “ *kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese*”. Ne rastin konkret palët me vullnetin e tyre kanë përcaktuar kushtet e kontratës duke përfshirë edhe rastin e mbuluar të vjedhjes, në kushtet e përgjithshme të sigurimit kasko në pikën 4 përfshihet edhe rasti i vjedhjes së mjetit motorik me të dhëna të përshkruara, prandaj në këtë rast kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka detyruar të paditurën që ta kompensojë dëmin.

Po ashtu me nenin 946 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se “ *me sigurimin e pasurisë sigurohet shpërblimi për dëmin që do të ndodhte në pasurinë e të siguruarit për shkak të paraqitjes së rastit të siguruar*”. Pra në këtë rast qëllimi juridik edhe ekonomik i lidhjes së kontratës së sigurimit të pasurisë qëndron në detyrimin themelor të siguresit të marrë me kontratën se të siguruarit ose shfrytëzuesit të sigurimit do t’ia kompensojë dëmin ose ndonjë mënyrë tjetër do ta përmbushë detyrimin e tij të kontraktuar, nëse ndodh rasti i siguruar. Në rastin konkret nga policori datës 26.01.2017, nr. Ref. ..., është vërtetuar se personi [A.J] që është personi i autorizuar i paditëses ka paraqitur rastin në polici se me datën 26.01.2017 ku është raportuar rasti i vjedhjes së veturës së tipit “Range Rover” me targa të regjistrimit Poashtu nga polica e sigurimi kasko me numër ... të lëshuar nga e paditura dhe kushteve të përgjithshme është vërtetuar se paditësi dhe e paditura me datën 11.01.2017 kanë lidhur policën e sigurimit të automjetit kasko për mjetin motorik Land Rover të tipit Range Rover Sport me targa të regjistrimit ..., ku kohëzgjatja e policës ka qenë deri me datën 11.01.2018. Nga raporti i ekspertizës së makinerisë të punuar nga z. [N.SH] të datës 12.03.2019 është vërtetuar se vlera e automjetit të markës Land Rover i tipit Range Rover Sport me targa të regjistrimit ... në ditën e vjedhjes ka qenë 50,180.00€, Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast ekziston obligimi i të paditurës që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 45,162.00€ emër të kompensimit të dëmit material për veturën e siguruar.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyqimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjyqimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale gjeti se kamata e aprovuar në shumën e gjykuar është zbatuar në mënyrë jo të drejtë me dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se “*debitori që vonon në përmbushjen e detyrimeve në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, ndërsa në pikën 2 përcaktohet se “*lartësia e kamatëvonesës është tetë 8% në*

vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Në këtë rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se duhet zbatuar nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, me të cilin është përcaktuar se: "Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim". Në këtë rast dispozitat e Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia që janë në fuqi nga data 23.06.2011, kurse rasti i vjedhjes ka ndodhur me datën 25.02.2017 në kohën kur ka qenë në fuqi, dhe në këtë rast gjykata është e obliguar në aplikimin e dispozitave që kanë qenë në fuqi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.387/19, dt.12.04.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.

